



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Kryetarja e Komunës

01nr _____

Dt: 21.04.2015

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 13 dhe 58 a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/ L-040, nenit 9 dhe 10 të Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve dhe Përfundimit nr.06-25194-9/2 të miratuar me dt: 03.04.2015 në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve, me të cilin është miratuar kërkesa e OJQ “27 Prilli 1999-Meje” për mbulimin e shpenzimeve operative për organizimin e manifestimit përkujtimore kushtuar Ditës së të Zhdukurave të Kosovës dhe Masakrës së 27 Prillit në Meje, me dt: 21.04.2015 e miraton këtë:

V E N D I M

I. Miratohet kërkesa e OJQ “27 Prilli 1999-Meje” në Gjakovë, për mbështetje financiare të kësaj shoqate për mbulimin e shpenzimeve operative për organizimin e manifestimit përkujtimore kushtuar Ditës së të Zhdukurave të Kosovës dhe Masakrës së 27 Prillit në Meje, duke e mbështetur me subvencione të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport në vlerë prej 500.20€.

II. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që të realizon procesin e zotimit të mjeteve financiare në vlerë prej 500.20€ nga mjetet e subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe bartjen e këtyre mjeteve në xhirollogarinë e OJQ “27 Prilli 1999-Meje” në Gjakovë, nr. 1140042475000140 Procredit Bank.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

IV. Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport
- Z. Haki Sadrija, kryetar i OJQ “27 Prilli 1999-Meje” Rr. “Nënë Tereza”, p.n. Gjakovë
- Arkivit

Kryetarja e Komunës,

Znj. Mimoza Kusari-Lila